

20232664606

**LIGJ I HUAMARRJES SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT ME HUA
NGA FONDI I ZHVILLIMIT NDËRKOMBËTAR TË ORGANIZATËS SË VENDEVE
EKSPORTUESE TË NAFTAË SIPAS MARRËVESHJES SË HUAS MBI PROGRAMIN
PËR QËNDRUESHMËRI DHE REZISTENCË**

Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut merr hua nga Fondi i Zhvillimit Ndërkombëtar të Organizatës së Vendeve Eksportuese të Naftës, me hua në vlerë prej 50.000.000 eurove, të caktuar për realizimin e Programit për qëndrueshmëri dhe rezistencë.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas së nenit 1 të këtijligji, përcaktohen me Marrëveshjen e huas për Programin për qëndrueshmëri dhe rezistencë, që do të nënshkruhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Fondit të Zhvillimit Ndërkombëtar në kuadër të Organizatës së Vendeve Eksportuese të Naftës - OPEC.

Në emër të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Marrëveshjen e huas së paragrafit (1) të këtij neni, do ta nënshkruajë ministri i Financave.

Neni 3

Afati për shlyerjen e huas së nenit 1 të këtijligji është 10 vjet, me periudhë mospagimi të përfshirë prej dy viteve.

Norma e interesit është EURIBOR gjashtëmujor i rritur për marginë prej 1.7%.

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së huas së nenit 2, paragrafi (1) të këtij ligji, Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Fondit të Zhvillimit Ndërkombëtar të Organizatës së Vendeve Eksportuese të Naftës, provizion të njëhershëm në vlerë prej 0.25% nga vlera e huas.

Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Fondit të Zhvillimit Ndërkombëtar të Organizatës së Vendeve Eksportuese të Naftës, provizion në vlerë prej 0.25% nga pjesa e patërhequr e huas në nivel vjetor.

Huaja e nenit 1 të këtij ligjit do të shlyhet në 16 këste gjysmëvjetore, më datë 15 janar dhe 15 korrik të çdo viti.

Neni 4

Shfrytëzuesi i mjeteve të huas së nenit 1 të këtij ligji është Ministria e Financave.

Neni 5

Republika e Maqedonisë së Veriut do ta shlyejë huan e nenit 1 të këtij ligji nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.